



NJOFTIM PËR PUBLIKUN

Prishtinë

15 prill 2019

Kuvendi i Republikës së Kosovës në Seancën e mbajtur me 28.03.2019, ka miratuar Ligjin nr. 06/L-155, ku sipas Nenit 1 ndalohen dhe mbyllën të gjitha lojërat e fatit në tërë Republikën e Kosovës¹, përfshirë dhe ndërprerjen e punës dhe veprimtarisë së Lotarisë së Kosovës sh.a.

Sipas Statutit të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 11/151 datë 02.08.2017., nenit 2.1., Lotaria e Kosovës është subjekt juridiko-publik dhe ka statusin e shoqërisë aksionare. Themelues - pronar i Lotarisë së Kosovës është Qeveria e Republikës së Kosovës dhe është themeluar për kohë të pacaktuar. Është pasardhës juridik i të gjitha të drejtave dhe pronës së Lotarisë së Kosovës të themeluar në vitin 1974.

Lotaria e Kosovës është anëtare e Asociacionit të Lotarive Shtetërore Evropiane (The European Lotteries) qysh nga viti 2002, nënshkruese e Standardeve Evropiane dhe e çertifikuar për Organizim me përgjegjësi shoqërore të lojërave të fatit nga viti 2017. Ky Asociacion përcakton standardet e organizimit me përgjegjësi të lojërave të fatit, ndërsa idetë dhe parimet që gjenden në ato dokumente Lotaria e Kosovës i respekton dhe i zbaton në punën dhe afarizmin e saj.

Lotaria e Kosovës është gjithashtu bashkëthemeluese e Asociacionit të Lotarive të Evropës Juglindore me seli në Lubljanë që nga viti 2007.

Lotaria e Kosovës me asgjë nuk i ka kontribuar situatës prej nga ka dal iniciativa për mbylljen e lojërave të fatit, pasi që nuk ka organizuar lojërat në kazino, automate dhe baste sportive. Gjithashtu, qysh nga fillimi i veprimtarisë së Lotarisë së Kosovës e deri me sot nuk ka pasur asnjë parregullsi.

Ligji është miratuar me procedurë të shpejt, pa pasur informata të mjaftueshme dhe pa konsultim me palët, në këtë rast me Lotarinë e Kosovës.

Ndërprerja e punës paraqet problem me furnizuesit dhe partnerët e jashtëm, shkakton grumbullimin e borxheve dhe ngecjen e të gjitha proceseve të parapara me planin e biznesit. Ajo do të ketë pasoja negative si për Qeverinë e Republikës së Kosovës ashtu edhe për Lotarinë e Kosovës dhe punëtorët e saj, disa nga të cilat janë:

¹ Me këtë Ligj ndalohen dhe mbyllën të gjitha lojërat e fatit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

- Rënia e të hyrave për buxhetin e Republikës së Kosovës;
- Mbetja pa punë e gjashtëdhjetë e gjashtë (66) të punësuarve, duke krijuar kështu gjendje të rëndë ekonomike dhe raste sociale për familjet e tyre;
- Institucionet e Kosovës duhet të marrin përsipër pagat e punëtorëve për kohën sa do të ndërpritet puna e Lotarisë së Kosovës;
- Obligimet ndaj pronarëve të lokaleve që i kemi të kontraktuara me qera dhe shërbejnë për pika të shitjes në qytete të ndryshme të Kosovës;
- Obligimet që kemi ndaj furnitorëve të jashtëm, për pajisje - terminale për shitjen e lojërave të fatit, shtypja dhe furnizimit me lotari instant, të kontraktuara dhe parapara me Planin e biznesit për vitin 2019;
- Reflektimi negativ në Asociacionin e Lotarive Evropiane me seli në Lozanë-Zvicër, ku Lotaria e Kosovës është anëtare nga viti 2002, dhe është e certifikuar nga ky Asociacion në vitin 2017 për Organizim me përgjegjësi shoqërore të lojërave të fatit;
- Obligimet tjera që dalin nga ushtrimi i veprimtarisë së sajë;

Bazuar në propozimet e dhëna në seancën e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtur me 28 mars 2019, presim që të bëhet miratimi i një ligji të veçantë për Lotarinë e Kosovës. Gjithashtu, Lotaria e Kosovës ofron bashkëpunimin e saj në përpilimin e projektligjit në mënyrë që të arrihet një ligj sa më i mirë dhe në një afat më të shpejtë kohorë.